



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I BASHKISË SKRAPAR

VENDIM

Nr.07, datë 22. 01. 2021

“PËR NJË SHITESË NË PLANIN E TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE TË BASHKISË SKRAPAR PËR VITIN 2021, NË ZERIN DONACIONE, PËR PROJEKTIN E FINANCUAR NGA UNDP-ALBANIA PËR NGRITJEN E FUNKSIONIMIN E MEKANIZMIT TË REAGIMIT TË KOORDINUAR (MRK) PËR ADRESIMIN E RASTEVE TË DHUNËS ME BAZË GJINORE DHE DHUNËS NE FAMILJE”

Këshilli Bashkiak Skrapar në mbledhjen e datës 22.01.2021, mori në shqyrtim projektaktin e hartuar nga grupi i punës për hartimin e PBA 2021-2023 dhe të buxhetit vjetor të vitit 2021 të Bashkisë Skrapar dhe Institucioneve në varësi të saj, në mbështetje të ligjit nr. 9936 dt. 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në R.SH”, i ndryshuar, Ligjit nr. 139/2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore“, ligjit nr.68/2017, “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore” Ligjit 137/2020 , ”Për buxhetin e vitit 2021”, si dhe në Udhëzimin e Ministrisë së Financave Nr.09, date 20.03.2018, “Për Procedurat Standarte të Zbatimit të Buxhetit“.

VENDOSI:

1. Planit të të ardhurave dhe shpenzimeve të Bashkisë Skrapar, për vitin 2021, në zërin donacione, ti shtohet vlera prej 811,700 lekë, për projektin e financuar nga **UNDP-ALBANIA**, për ngritjen e funksionimin e mekanizmit të reagimit të koordinuar (MRK) për adresimin e rasteve të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës ne familje.
2. Donacioni të detajohet në nivel programi, kapitulli dhe artikulli duke ju shtuar buxhetit të vitit 2021 si më poshtë:

Grupi	Programi	Kapitulli	Artikull	Vlera
01	10430 (kujdesi social për familjet dhe fëmijët)	05	602	811.700



Rruga: “Pasho Hysi” Lagjja: “Çlirimi” Çorovodë, Skrapar Telefon: +355 31222512email:bashkiacorovode@ymail.com



3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet: Drejtoria e Financës Buxhetit dhe Tatim Taksave

4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të Ligjit Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore".

Vendimi u miratua me 14 vota pro , vota kundër - s'ka , vota abstenim - s'ka .

Për konfirmim Prefektit të Qarkut Berat .

KRYETARE KËSHILLIT BASHKIAK

Edlira SHKËMBI

